

# **Mekanizmi Kombëtarë i Referimit**

*Një guidë për prindërit*

## Çfarë është MKR?

MKR ose “Mekanizmi Kombëtarë i Referimit” është një kornizë për të identifikuar viktimat e trafikimit njerëzorë dhe Skllavërisë Moderne.

Nëpërmjet këtij procesi duhet të sigurojë që viktimat marrin mbështetjen e duhur dhe se eksperiencat e tyre njihen.

## Çfarë është trafikimi njerëzorë?

Një fëmijë duhet të njihet si viktimë trafikimi nëse dy nga gjërat e mëposhtme ndodhin:

**1.**

Fëmija është rekrutuar (për shembull përmes parave, dhuratave, statusit social dhe / ose duke u dhënë ndjenjën e përkatësisë ose identitetit – ne e quajmë këtë “grooming”)

OSE

Fëmija është transportuar nga A në B (qoftë në distancë të shkurtër ose largët, duke përfshirë brenda të njëjtit fshat ose nga qyteti në qytet)

OSE

Fëmija është strehuar. Strehim nënkupton mbajtjen dhe strehimin e dikujt, përshembull në një fermë për pune manuale, ose në një shtëpi që përdoret si bazë për kultivimin dhe shpërndarjen e drogës (shpesh këto shtëpi quhen “shtëpi kurth”)

**2.**

Është bërë me qëllim që të shfrytëzohet.

Përshembull, një i ri dërgohet me tren nga një vend në tjetrin për të shpërndarë drogë. Këtë e quajmë shfrytëzim kriminal

Një tjetër shembull është rasti kur llogaria e një të riu përdoret për të mbajtur paratë të cilat janë fituar në mënyrë ilegale. Ne e quajmë këtë shfrytëzim financiar

Një shembull i shfrytëzimit të punës përfshin rastin kur një i ri detyrohet të “punojë” pa e paguar

Ose shfrytëzim seksual kur ata detyrohen të kryejnë marrëdhënie seksuale me një ose më shumë persona

# The Children's Society

**Ashtu si të gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve, trafikimi i qënieve njerëzore dhe Skllavërimi Modern përfshin një disbalancë fuqie mes të riut dhe atyre që i kontrollojnë ata (përshembull për shkak të moshës ose statusit).**

Nëse një fëmijë trajtohet si “pronësi” (si të jetë një copë pronë) nga dikush ose janë bërë për të punuar diku dhe janë të pafhtë për t'u larguar njihet me termin Skllavëri Moderne.

Është e rëndësishme të theksohet se cdo fëmijë nga çdo lloj prejardhje mund të shfrytëzohet. Nuk ka turp për këtë, sidoqoftë është e rëndësishme të dallohen shenjat dhe denoncohet në mënyrë që fëmija të marrë suportin e duhur. MKR nuk është një alternativë ndaj procedurave normale të mbrojtjes, përkundrazi procesi i MKR duhet t'i plotësojë këto. Prandaj denoncimi i shqetësimeve tuaja në polici dhe në autoritetet sociale lokale është ende thelbësore.

## Proçesi i referimit të MKR

Prindërit nuk mund të referojnë vetë MKR, por organizma të tillë si policia dhe qendrat sociale e kanë për detyrë të bëjnë referim te Zyra e Përkujdesjes Sociale nëse dyshojnë se dikush mund të jetë viktimë e trafikimit njerëzorë. Profesionistët të cilët e kanë për detyrë të bëjnë referime quhen **përgjegjësit e parë**.

- Nëse shenjat e trafikimit (siç njihen ndryshe dhe indikatorët) janë prezentë, është e mjaftueshme për një përgjegjës që të bëjë një referim te Zyra e Përkujdesjes Sociale.
- Zyra e Përkujdesjes Sociale vendos më pas nëse një person duhet të regjistrohet si viktimë trafikimi apo jo.
- Disa organizata bamirësie gjithashtu mund të referojnë MKR dhe këshillojnë. Si përshembull ju mund të telefononi për ndihmë [NSPÇ helpline](#) ose [Modern Slavery helpline](#).

## Çfarë do të thotë vendimi i MKR?

Proçesi i vendimarrjes ka dy hapa:

1. Një **Vendim i Arsyeshëm** duhet të merret brenda pesë ditëve. Kjo nënkupton **“Unë dyshoj por nuk mund të provoj”** ata janë viktimë.
2. Pas kësaj duhet të mërret një **Vendim mbi Provat Përfundimtare**. Kjo nënkupton “ka më shumë të ngjarë se jo” ata janë viktimë.

Informacione shtesë mund t'i dërgohen Zyrës së Përkujdesjes Sociale derisa ata të marrin një Vendim Përfundimtarë. Çdo informacion i ri shtesë do i ndihmojë në vendimin e tyre. Ndërsa prindërit nuk mund të bëjnë një referencë MKR, mund t'u jepni informacion te ri pas referimit. Ne do të inkujaronim që kjo gjë të bëhej në partnership me personin ose organizatën që ka bërë referimin, nëse do ishte e mundur. Informacioni i ri shtesë duhet të dërgohet te [nationalreferralmechanism@homeoffice.gov.uk](mailto:nationalreferralmechanism@homeoffice.gov.uk)

# The Children's Society

Nëse një person identifikohet si viktimë e trafikimit, kjo gjë ndikon në mënyrën sesi ata trajtohen kur ata arrestohen ose përballen me dënimin e një krimi që kanë kryer, sepse i riu ka qënë i shfrytëzuar. Në këtë rast viktimat e trafikuar kanë të drejtën të përdorin mbrojtje ligjore të quajtur Mbrojtja Moderne e Skllavërisë dhe duhet ta diskutojnë me avokatin e tyre.

Nëse një fëmijë merr një Vendim Përfundimtarë pozitiv nga Zyra e Përkujdesjes Sociale atëherë atyre duhet t'u sigurohet suport, si terapia për t'i ndihmuar që ta marrin veten nga kjo eksperiencë.

Ky suport duhet të sigurohet nga shërbimet sociale dhe vendimi i MKR duhet të jetë pjesë e vendimarrjes së mbrojtjes së tyre. Si prind ju mund të përdorini vendimin pozitiv për të kërkuar suport nga shërbimet sociale. Fëmija juaj gjithashtu mund të aksesojë suport nga [Independent Child Trafficking Guardianship Service](#).

Nëse fëmija juaj po kërkon azil ose mbrojtje në UK atëherë vendimi i MKR mund të jetë i përshtatshëm për këtë. Në disa raste një MKR pozitive mund të ndikojë që Zyra e Mbrojtjes Sociale t'i japë fëmijës suaj leje qëndrimi për në UK. Është e rëndësishme që ju të përfshini avokatin e emigracioni sa më shpejt, që në mundësinë e parë, mundësisht para se MKR të dorëzohet. Ata mund të sigurojnë këshillim për MKR dhe lidhjen e tij për mbrojtjen e fëmijës suaj

## Po nëse ju nuk jeni të kënaqur me vendimin e MKR?

Ju ose fëmija juaj keni të drejtë të kërkonit që vendimi i MKR të rishikohet nga Zyra e Mbrojtjes Sociale nëse nuk jeni të kënaqur me të. Gjithashtu ju keni të drejtën e përfaqësimit ligjorë për të kundërshtuar vendimin dhe kjo duhet bërë nga një Avokat i Ligjit Publik (ndihma juridike mund të jetë e disponueshme në varësi të rrethanave tuaja). Ju mund të gjeni Avokat të së Drejtës Publike [këtu](#)

## Ku të kërkonit ndihmë

Për të kërkuar ndihmë ose folur për ndonjë shqetësim ju mund të telefononi linjën e Ndhmës së Skllavërisë Moderne (Modern Slavery Help) në numrin **0800 012 1700 ose linjën NSPÇ** në numrin **0808 8005000**.

Nëse fëmija juaj nuk dëshiron të flasë me ju për situatën e tyre, ose edhe nëse duan, bëni me dije se ata gjithmonë mund të telefonojnë Childline në numrin 0800 1111 ose mund t'u shkruajnë online, me detajet e dhëna si [këtu](#). Në disa zona të UK fëmijët mund të kenë ndihmën e Shërbimit të Pavarur të Kujdesit për Trafikimin e Fëmijëve (Independent Child Trafficking Guardianship Service). Për të zbuluar nëse fëmija juaj mund të marrë këtë mbrojtje telefononi Barnardo's në numrin 0800 0434303 e cila është 24 orë e disponueshme

**Nëse jeni i shqetësuar që fëmija juaj është në rrezik ose dëmtuar, ju lutem telefononi policinë në numrin 101 ose 999 në rast emergjence dhe shpjegouani që jeni të shqetësuar që fëmija juaj po trafikohet.**

Gjithashtu do ju inkurajonim të telefononi Skuadrën e Shërbimit Social – detajet janë të disponueshme në websit-in e këshillit tuaj lokal. Ju mund të gjeni cili është këshilli juaj lokal (local council) [këtu](#)